

UNITED NATIONS  
**United Nations Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo**



NATIONS UNIES  
**Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo**

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

- Duke u nisur nga pika 11 e Rezolutës 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila parasheh për Kosovën një vetëqeverisje substanciale deri në zgjidhjen e statusit final të Kosovës;

- Duke u nisur nga përcaktimi i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, e cila parasheh zgjidhjen e statusit final të Kosovës në një fazë të mëvonshme, duke marrë për bazë vullnetin e popullit;

- Duke vërejtur përpjekjet e të ashtuquajturit Union të Sërbisë dhe të Malit të Zi, që nëpërmjet Kartës Kushtetuese, të krijojë bazë kushtetuese për aneksimin e Kosovës;

- Duke konstatuar se veprimet e këtilla janë të papranueshme për popullin e Kosovës dhe paraqesin rrezik për paqen dhe stabilitetin në Kosovë, në rajon dhe më gjerë; Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 7.11.2002, miraton këtë:

## **REZOLUTË**

I Kuvendi i Kosovës shpall të papranueshme dhe të pavlefshme përcaktimet kushtetuese të shprehura në Kartën Kushtetuese, të të ashtuquajturit Union të Sërbisë dhe Malit të Zi lidhur me Kosovën.

II Kuvendi i Kosovës rikonfirmon qëndrimin se statusi final dhe juridik i Kosovës do të përcaktohet në një fazë të mëvonshme nga institucionet demokratike dhe populli i Kosovës në bashkëpunim me faktorët ndërkombëtarë.

III Kuvendi i Kosovës kërkon nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, Bashkimi Evropian dhe faktorët e tjerë ndërkombëtarë që t'u kundërvihen përpjekjeve të Serbisë dhe Malit të Zi për të prejudikuar statusin e ardhshëm

të Kosovës dhe aneksimin e saj, tendenca këto që rrezikojnë paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë.

IV Kuvendi i Kosovës, me vemendje të posaçme do të përcjellë zhvillimet e mëtejshme dhe qëndrimet e Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj këtij provokimi që i bëhet Kosovës dhe do të marrë vendime adekuate.

Prishtinë, 7.11.2002

**Kuvendi i Kosoves**

**U dërgohet :**

- **KS të OKB-së**
- **Bashkimit Evropian**
- **PSSP**
- **Kryetarit të Kosovës**
- **Qeverisë së Kosovës**